



KLUBI
I ORIENTIMIT
TIRANA



FTESË

Garë orientimi në Parkun e Madh të Tiranës

Me rastin e Kampionatit XVI Mesdhetar të Orientimit, zhvillohet në Tiranë etapa e katërt e MOC Tour 2020

të Mërkurën, më 18 Mars 2020, ora 14:00

Klubi i Orientimit Tirana, në bashkëpunim me

Agjencinë e Parqeve dhe Rekreacionit dhe

Bashkinë e Tiranës,

ka nderin t'ju ftojë të bëheni pjesë e garës.

Në këtë ngjarje të rëndësishme të sportit të orientimit në Shqipëri, do të keni mundësinë të zgjidhni për të garuar mes disa kategorive. Mund të vraponi përkrah pjesëmarrësve nga 15 vende të ndryshme të botës dhe të zgjidhni mes shënimit manual ose elektronik të pikëve. Mbi të gjitha do të argëtoheni dhe njiheni më mirë me sportin e orientimit!

Programi:

- **14:00** takimi në Amfiteatrin e Parkut të Liqenit Artificial të Tiranës
- **15:00** Nisja e parë: Distanca e mesme
- **17:30** Përfundimi i garës

Mbas përfundimit të garës: Cermonia e dhënies së çmimeve

REGJISTRIMI

Për më shumë informacion dhe Për t'u regjistruar na kontaktoni në:

Cel. 00355 698546633

orientimtirana@yahoo.com

info@orienteering-al.com

GARA ME SISTEM ELEKTRONIK

Ky sistem ju mundëson matjen e pikëve me shënues me sensor elektronik SPORTident. Kushton më tepër se sistemi manual, por është i vetmi që ju lejon të garoni bashkë më pjesëmarrësit ndërkombëtarë të MOC Tour 2020. Afati i fundit për regjistrimin me këtë sistem matjeje është data 5 mars. *

KATEGORITË E GARUESVE ME SISTEM ELEKTRONIK

***M/W 16, M/W 21, M/W 50, M/W 60, M/W 65, M/W 70, M/W 75**

OPEN 1. (Niveli i vështirë)

OPEN 3. (Niveli fillestar)

*M = Meshkuj

W = Femra

OPEN = Kategori e hapur

Kategoritë	Regjistrimi deri në 10 Mars 2020
M/W 16 dhe OPEN	600 lekë
Nga M/W 21	700 lekë

* Në rast humbjeje të pajisjes SPORTident, duhet të paguani vlerën e saj 40€.

GARA ME SISTEM MANUAL

Gara me këtë sistem bën mbledhjen e pikëve me anë të shënuesve të orientimit me kapëse. Është varianti më i lirë dhe me kohëzgjatjen më të madhe për regjistrim deri në datën 15 mars.

KATEGORITË E GARUESVE ME SISTEM MANUAL:

M/W 16, M/W 50, OPEN 3. (Niveli fillestar)

PAGESA

- Fëmijët deri në moshën 14 vjeç – pa pagesë
- 14-18 vjeç – 100 Lekë
- Mbi 18 vjeç – 200 Lekë
- Sistemi i shënimit: SPORTident, vetëm për regjistrimet deri në datën 10 mars 2020
- Pas afatit të fundit është e mundur të regjistroheni vetëm në rast se ka dispozicion dhe me kosto 700 lekë për garë.
- Garat do të organizohen në përputhje me rregullat e IOF.
- Të gjithë garuesit marrin pjesë në garë nën përgjegjësinë e tyre të plotë; organizuesi ofron vetëm ndihmën mjekësore bazë në mbërritje. Pjesëmarrësit nuk sigurohen nga organizuesi, për dëmet që u shkaktojnë personave të tjerë ose vetvetes. Rekomandohet siguracioni individual.
- Në rast të anulimit të garës për motive që nuk lidhen me organizuesin, organizimi nuk mban asnjë përgjegjësi.
- Të gjithë garuesit e regjistruar janë automatikisht dakord me publikimin e fotove të tyre gjatë evenimentit dhe të rezultateve në faqen e internetit. Përndryshe, ju lutemi të informoni organizuesit në momentin e regjistrimit.
- Ju lutemi të lexoni me kujdes të gjithë informacionin e organizmit dhe atë që përmban ky njoftim.

Organizatorë: Inge Bosina dhe Klubi i Orientimit Tirana. Ju mirëpresim!

- Për më shumë informacion: <http://orienteering-al.com/>

Klubi i Orientimit Tirana

